



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

N. 6305

BASHKIA FIER
KËSHILLI BASHKIAK

D+18052026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 51, datë 18052026

PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E KËRKESËS PËR PAJISJEN ME ZYRË VENDORE TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE TË SHQIPËRISË.

Në mbështetje të Nenit 9 (pika 1.3), Nenit 54 dhe Nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Nenit 22, shkronja "b" të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", të ndryshuar; përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 25, datë 20.04.2023 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë për zyrat qendrore dhe vendore të partive politike"; si dhe në referim të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Bashkiak Fier, me propozim të Kryesisë së Këshillit Bashkiak, Këshilli Bashkiak:

Propozon::

1. Miratimin në parim të kërkesës nr. 2327 prot., datë 05/05/2026, të paraqitur nga Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, për pajisjen me një ndërtesë për zyrë vendore në territorin e Bashkisë Fier.
2. Ngarkimin e administratës së Bashkisë Fier (Drejtoria e Administrimit të Pronave) që, brenda një afati prej 10 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të kryejë verifikimin e plotë të aseteve dhe të identifikojë një ambient të lirë e të përshtatshëm nga fondi i pasurive të paluajtshme të bashkisë, me sipërfaqe jo më shumë se 50 m².
3. Në rast të pamundësisë objektive për sigurimin e një ambienti nga fondi i aseteve të lira të bashkisë, ngarkohet Kryetari i Bashkisë të njoftojë zyrtarisht subjektin kërkues për ushtrimin e të drejtës së marrjes së ambientit me qira nga të tretët (pronarë privatë), duke marrë përsipër mbulimin e kostos së qirasë nga buxheti i bashkisë / fondet përkatëse, brenda kufijve maksimalë ligjorë në fuqi (750 lekë/m² për zyra pa pajisje dhe 1,000 lekë/m² për zyra me pajisje).

4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë Fier dhe Drejtorja e Administrimit të Pronave.

Kryesia e Këshillit Bashkiak

1-Melsi Bogdani

2-Arben Çuko

3-Fatbardha Merkaj

4-Marjus Voja

5-Kreshnik Dapi

6-Endri Jaupaj

7-Rrapi Gjika

